



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-072
Prishtinë, më 1 shtator 2016, ora 13:20

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 1 SHTATOR 2016**

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Para se ta procedojë rendin e ditës, kryetari i njoftoi deputetët për zëvendësimin e deputetes nga radhët e GP të LDK-së. Me kërkesë të kryetarit të Kuvendit e me vendim të Presidentit të Republikës së Kosovës është bërë zëvendësimi i deputetes në Kuvendin e Republikës së Kosovës, znj. Kimete Bytyqi, kandidate e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK, e cila zëvendëson ish-deputeten, znj. Alma Lama.

Kryetari e ftoi deputeten që të ngritët në këmbë dhe ta dëgjojë tekstin e betimit që ai e lexoi, në fund ajo e shqiptoi fjalën “b e t o h e m” dhe e nënshkroi tekstin e betimit.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Ismajl Kurteshi, Margarita Kadriu, Kujtim Paçaku, Adem Grabovci, Besa Gaxheri, Glauk Konjufca, Rexhep Selimi dhe ministri Skender Hyseni, të cilat janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Ganimete Musliu i parashtroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, z. Skender Hyseni, lidhur me masat e ndërmarra nga kjo ministri për zvogëlimin e aksidenteve në komunikacion.

Ministri Skender Hyseni iu përgjigj deputetes Ganimete Musliu.

Deputetja Ganimete Musliu i parashtroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, z. Skender Hyseni, lidhur me masat e ndërmarra nga kjo ministri për konfiskimin e armëve pa leje.

Ministri Skender Hyseni iu përgjigj deputetes Ganimete Musliu.

Deputeti Bekim Haxhiu i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, z. Arsim Bajrami, lidhur me masat e ndërmarra nga kjo ministri për zvogëlimin e peshës së çantave të nxënësve të shkollave fillore, që po paraqitet njëra ndër shkaktarët për dëmtimin e boshtit kurrizor të fëmijët-nxënës.

Ministri Arsim Bajrami nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli i kishte parashtruar pyetje ministrit të Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi, lidhur me masat e ndërmarra nga kjo ministri për hapjen e zyrave për ndihmë juridike falas edhe për qytetarët e rajonit të Ferizajt dhe të Gjakovës.

Ministrja Dhurata Hoxha iu përgjigj deputetes Mexhide Mjaku-Topalli.

Deputeti Ismajl Kurteshi kishte parashtruar pyetje për ministrin Arban Abrashi dhe ministrin Arsim Bajrami, por ai tha se ato do t'i paraqesë në Sesionin vjeshtor, pas datës 12 shtator 2016.

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 4 e 5 gusht 2016.

Kryetari, para se t'i procedojë pikat e tjera të rendit të ditës, i njoftoi deputetët se kryetari i GP të Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, me shkresë të datës 30 gusht 2016 ka njoftuar se i tëheqin nga rendi i ditës së seancës së sotme dy pikat:

4. Interpelanca e Kryeministrit Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 7 deputetë nënshkrues, në lidhje me kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës, dhe

5. Interpelanca e Kryeministrit Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Ismajl Kurteshi, i mbështetur edhe nga 10 deputetë nënshkrues, në lidhje me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës.

Pastaj, kryetari procedoi pikën e 6-të.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Punë të Jashtme e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Kryeministri i Kosovës, z. Isa Mustafa, tha se sot nuk janë rrethanat dhe nuk është situata, në të cilën duhet ta shqyrtojmë dhe ta votojmë Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes me Malin e Zi. Prandaj, Qeveria e Kosovës e tërheq sot këtë projektligj nga rendi i ditës dhe nga procedura kuvendore.

Lidhur me vendimin e kryeministrit të Kosovës për tërheqjen e Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi nga shqyrtimi i mëtejshëm në Kuvend diskutuan: Daut Haradinaj, Fatmir Limaj, Zenun Pajaziti, Glauk Konjufca, Ismet Beqiri, Shaip Muja dhe Gëzim Kelmendi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund të këtyre diskutimeve, kryetari në orën 14:45 i mbylli punimet e kësaj seance dhe të Sesionit pranveror, për t'i vazhduar punimet Kuvendi në Sesionin vjeshtor të hënën e dytë të muajit shtator 2016.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale